

Urbanizmi i mbyllur i Prizrenit

Shtator 2017, Prizren

PËRMBAJTJE

I. Hyrje.....	1
II. Korniza ligjore.....	3
III. Urbanizmi i mbyllur dhe pjesëmarrja e ultë e qytetarëve ne Prizren.....	6
IV. Rekomandime	9



Ky raport është përgaditur në kuadër të projektit "Transparenca e Planifikimit Hapësinor në Prizren" i cili synon hapjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor në komunën e Prizrenit, për të përmbushur obligimet e Kartës për Hapjen e të Dhënave, dhe rritur nivelin e llogaridhënies publike në këtë sektor. Hapja e të dhënave dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor do të krijojë mundësi më të mëdha për mbikëqyrjen e punës së autoriteteve publike në raport me urbanizmin, lejet e ndërtimit, planifikimin zhvillimor dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Projekti përkrahet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)

Hyrje

Normat e qeverisjes së mirë urbane sipas Programit të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-HABITAT) përfshijnë qëndrueshmërinë, subsidiaritetin, barazinë, efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien, përfshirjen qytetare dhe sigurinë.¹

Kjo Agjenci e Organizatës së Kombeve të Bashkuara konsideron se transparenca në vendimmarrje dhe llogaridhënia e autoriteteve lokale në raport me qytetarët paraqesin parimet themelore të qeverisjes së mirë. Po ashtu pohon se transparenca dhe llogaridhënia janë esenciale që hisedarët ta kuptojnë qeverisjen lokale. Prandaj qasja në informata është elementi kryesor për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies. Në kontekstin e planifikimit urban strategjik, sipas UN-HABITAT, transparenca dhe llogaridhënia mund të arrihen përmes përfshirjes aktive të hisedarëve në caktimin e prioritetëve dhe marrjen e vendimeve. Përfshirja e hisedarëve në caktimin e prioritetëve dhe përgatitjen e planeve të veprimit duhet të fuqizohet me lehtësimin e qasjes në informata, përfshirë statistikën dhe të dhënat financiare. Madje këto sisteme duhet të dizajnohen në atë mënyrë që janë të qasshme për të gjitha segmentet e popullatës.²

Sa i përket parimit të përfshirjes së qytetarëve, UN-HABITAT thekson se qytetarët janë pasuria kryesore e qyteteve dhe se ata aktivisht duhet të kontribuojnë për të mirën e përbashkët. Qytetarët, e veçanërisht gratë, duhet të

fuqizohen për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse, përderisa angazhimi i të gjithë hisedarëve mundëson zbatimin më të suksesshëm të planeve zhvillimore.³

Komuniteti i profesionistëve ndërkombëtarë vlerëson se planifikimi hapësinor është proces që kujdeset për interesin e përbashkët të shoqërisë. Për ta jetësuar këtë sipas tyre duhet të zbatohet parimi i pjesëmarrjes, përkatësisht që të gjithë akterët dhe hisedarët të marrin pjesë aktivisht në proces. Ndërmjetësimi në mes të gjitha interesave, duke garantuar se nuk do të merren parasysht vetëm interesat e grupeve të fuqishme të interesit është i domosdoshëm. Ndërkohë, profesionistët argumentojnë se pjesëmarrja e publikut në planifikim është i padobishëm nëse bëhet në fund të procesit, prandaj që procesi i planifikimit hapësinor të jetë përfshirës, komunikimi i ideve dhe objektivave duhet të bëhet para marrjes së vendimit për çështjen e caktuar. Ata pajtohen se parimi i pjesëmarrjes është i lidhur me parimin e transparencës, ku barazia e procesit të planifikimit mbështetet në vullnetin për ti hapur idetë për çdo palë të përfshirë. Prandaj konsiderojnë se procesi duhet të jetë i dukshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, derisa informata që i jepet publikut duhet të jetë relevante, e qasshme, në kohë dhe e saktë. Në të njëjtën ka rëndësi të dihet se kush po i merr vendimet dhe çfarë janë ato vendime, gjë që ndërlidh parimin e llogaridhënies që siguron se akterët mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Parimet e sipërpërmendura janë të rëndësishme në shtetet demokratike pasi që ato ia mundësojnë qytetarit/es të/së zakonshëm/e që të marrin pjesë në vendimet që ndikojnë në jetesën dhe mjedisin e tyre. Këto parime janë të ndërlidhura dhe mund të përforcojnë njëra-tjetrën për të

¹"Inclusive and Sustainable Urban Planning: A Guide for Municipalities", Vol. 1, UN-HABITAT, 2007, <https://unhabitat.org/ep-content/uploads/2014/07/A-guide-for-Municipalities-Inclusive-and-Sustainable-Urban-Development-Planning-Volume-1.pdf>, qasur me 30 gusht 2017

² Po aty

³ Po aty

arritur barazinë dhe drejtësinë në procesin e planifikimit.⁴

Demokracia e avancuar e shteteve perëndimore ofron shembuj të shumtë të asaj se si institucionet qendrore dhe ato lokale kanë zhvilluar transparencën dhe llogaridhënien karshi qytetarëve. Për më tepër, transparenca në shtetet e BE-së është obligim institucional dhe si e tillë, të gjitha institucionet e BE-së, shtetet e anëtare të saj, institucionet e shteteve anëtare, etj., janë të obliguara që të qeverisin në mënyrë transparente, duke i dhënë llogari qytetarëve për çdo vendim. Traktati mbi Bashkimin Evropian, në nenin 1 thekson se “vendimet (brenda BE-së) duhet të merren në mënyrën më të hapur (më transparente) të mundshme”. Traktati mbi funksionimin e Bashkimit Evropian, në nenin 15 thekson se “për të promovuar qeverisjen e mirë dhe për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile, institucionet e BE-së, organet, zyrat dhe agjencitë duhet të kryejnë punën e tyre në mënyrën më të hapur (transparente) të mundshme”. Po në këtë nen theksohet se “çdo qytetar i BE-së dhe çdo person fizik ose juridik që banon ose ka zyrën e saj të regjistruar në një shtet anëtar, ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve të BE-së, organeve, zyrave dhe agjencive të saj”.⁵

Parimet për transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike si dhe ai i detyrimit të tyre për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe planifikim janë të normuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës duke marrë parasysh edhe standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Mirëpo në praktikë, ende

ka probleme të theksuara me zbatimin e këtij legjislacioni, gjë që rezulton në transparencë të ulët të Komunave dhe të organeve të Qeverisë së Kosovës si dhe në pjesëmarrje të ultë të qytetarëve në dëgjime publike për politikën e ndryshme të qeverisjes lokale dhe asaj qendrore. Në këtë drejtim, Komuna e Prizrenit përbën një shembull negativ për shkak të transparencës dhe llogaridhënies së ultë të departamentit të Urbanizmit dhe të Planifikimit Hapësinor, gjë që rrjedhimisht me vete sjellë edhe pjesëmarrjen e ultë të qytetarëve në vendimmarrje dhe planifikim.

I. Korniza Ligjore

i) Korniza ligjore për transparencën në Komuna

Kushtetuta e Kosovës ofron bazë të qëndrueshme juridike sa i përket transparencës së institucioneve duke përfshirë edhe transparencën në komuna. Neni 40 dhe 41 i Kushtetutës garantojnë të drejtën e qytetarëve për të ndarë dhe marrë informata, përkatësisht të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet e institucioneve publike dhe të organeve të pushtetit shtetëror.

Në përputhje me Kushtetutën e vendit, më tej janë hartuar dhe miratuar një numër i ligjeve dhe akteve tjera nënligjore me të cilat përcaktohen të drejtat e qytetarëve në procese me interes publik në nivel lokal dhe në të njëjtën kohë janë përcaktuar edhe obligimet që kanë institucionet qendrore dhe ato lokale në sigurimin e kushteve të nevojshme për të qenë transparent karshi qytetarëve.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike - konsiderohet si dokumenti më i rëndësishëm me të cilin synohet të arrihen standardet ndërkombëtare të transparencës. Ky ligj i garanton secilit qytetar të drejtën për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo të pranuar nga institucionet publike. Me këtë ligj rregullohen të gjitha

⁴ Principles of Spatial Planning: Participation and Transparency”, nga Bettisabel Lamelo Viña, 2014, linku: <https://emurbanism.ēeblog.tudelft.nl/2014/11/12/principles-of-spatial-planning-participation-and-transparency/>

⁵ "Udhëzues për transparencë në komuna", EC Ma Ndryshe, prill 2014, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/Udhezues_per_Transparence.pdf, qasur me 29 gusht 2017

procedurat e nevojshme për qasje në dokumente publike duke filluar nga kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përpunimi i kërkesave dhe lejimi i qasjes në dokumente publike. Më këtë ligj të gjitha institucionet publike obligohen që t'i publikojnë të gjitha dokumentet dhe të kenë një adresë e-maili për komunikim me publikun.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale - është ligj bazik për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në Kosovë. Ky ligj parasheh shumë obligime për institucionet e pushtetit lokal ndër të cilat edhe ato që lidhen me transparencën e komunave. Këto obligime mund të trajtohen në disa dimensione:

-Dimensionimi i parë ka të bëjë me të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e komunës.

Ky ligj i obligon komunat që t'i njoftojnë qytetarët mbi mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës shtatë përkatësisht tre ditë pune para datës së mbledhjes. Ky obligim vlen edhe për mbledhjet e komiteteve të Kuvendit të Komunës.

-Dimensionimi i dytë lidhet me obligimin e komunave për organizimin e takimeve publike. Në bazë të kësaj, komunat janë të obliguara që së paku dy herë në vit (njërën në gjashtëmujorin e parë të vitit dhe të dytën në gjashtëmujorin e dytë të vitit) të mbajnë takime publike në të cilat mund të merr pjesë secili qytetar i komunës përkatëse. Në këto takime përfaqësuesit e komunës janë të obliguar t'i informojnë qytetarët mbi aktivitetet e komunës, ndërkohë që pjesëmarrësit kanë të drejtë të shtrojnë pyetje dhe të paraqesin propozime për zyrtarët e komunës. Krahas kësaj, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës mbi të gjitha rregulloret, planet dhe politikat e komunës me interes të përgjithshëm për qytetarët e komunës.

-Dimensionimi i tretë ka të bëjë me të ashtuquajturën demokraci të drejtpërdrejtë në

të cilën përfshihet e drejta e qytetarëve për peticion, iniciativa të qytetarëve për të propozuar rregullore komunale, referendum dhe për të ndërmarrë iniciativë për largimin e kryetarit të komunës.

-Dimensionimi i katërt parasheh të drejtën e kuvendeve të komunave për themelimin e komiteteve konsultative me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Statusi i këtyre komiteteve është këshillëdhënës dhe anëtarë të këtyre komiteteve duhet të jenë ekskluzivisht qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të komunave përkatëse.

Ligji për vetëqeverisjen lokale në të njëjtën kohë obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës. Me qëllim të lehtësimit të procedurave të hartimit e këtyre rregulloreve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hartuar një udhëzim të veçantë administrativ për transparencën në komuna.

Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna - rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të organeve të saj, detyrimin për njoftim publik, konsultimin e publikut mbi politikat komunale etj. Për dallim prej ligjit për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimi Administrativ për transparencën në komuna jep përkufizime më konkrete të obligimeve të komunave dhe adreson përgjegjësinë për ndërmarrjen e veprimeve. Udhëzimi Administrativ për transparencën në komuna obligon komunat që krahas organizimit të së paku dy takimeve publike gjatë vitit, të organizojnë edhe takime shtesë për çështje që lidhen me buxhetin e komunës, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale etj. Komuna duhet t'i njoftojë qytetarët së paku dy javë para mbajtjes së takimit publik dhe atë përmes

shpalljeve publike, mediave dhe faqes elektronike të komunës.

Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike – është akt që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat tjera që duhet të kenë të gjitha ueb faqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave. Këtu përmendet edhe obligimi që institucionet në ueb faqet e tyre të publikojnë një adresë e-maili për komunikim me publikun që në vazhdimësi kontrollohet nga personi përgjegjës, në vazhdimësi të përditësojnë të dhënat e publikuara në ueb faqe, të kenë të zhvilluar dhe të funksionalizuar modulën e kërkimit, etj.

Rregullorja Komunale për Transparencë – është akt komunal, i cili duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës në përputhje me Udhëzimin Administrativ për transparencën në komuna. Rregullorja për transparencë synon forcimin e transparencës së organeve të komunës, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet publike të komunës. Në një formë, ajo mund të konsiderohet edhe “adoptim” i Udhëzimit Administrativ për transparencën në komunën përkatëse duke marrë në konsideratë kushtet dhe rrethanat specifike të saj.⁶

ii) Korniza ligjore për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor – përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, llojet, ecuritë dhe përmbajtjen e planeve, përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e këtij ligji, si dhe aktivitetet të cilat ndërmerren në planifikim hapësinor dhe rregullim territorial në Republikën e Kosovës.

Planifikimi hapësinor dhe rregullimi bazuar në dispozitat e këtij ligji duhet të bazohen në parimin e promovimit të procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndërsektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, pastaj promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor dhe promovimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor. Ligji parasheh që autoritetet e planifikimit hapësinor para se t’i finalizojnë të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor, përmes njoftimit publik ti ftojnë qytetarët dhe të zhvillojnë konsultime dhe shqyrtime publike, në mënyrë që të inkurajojnë pjesëmarrjen transparente të publikut dhe të përfshijë vlerësimet publike lidhur me ndikimet e mundshme sociale, ekonomike dhe mjedisore. Me këtë ligj po ashtu duhet të sigurohet pjesëmarrja e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, ndërkohë që të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor duhet të përmbajnë raportin e shqyrtimit të propozimeve dhe vërejtjeve publike dhe peticioneve nga pronarët e tokave.

MMPH me akt të veçantë respektivisht me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor ka përcaktuar përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, njoftimit publik, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të debatit publik, trajtimin e peticioneve, si dhe përgatitjen e raportit shqyrtues të propozimeve dhe vërejtjeve publike.

⁶ Po aty

Udhëzimi Administrativ i MMPH Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor -përcakton parimet për organizimin e prezantimeve, shqyrtimit publike dhe të gjitha formave tjera të pjesëmarrjes publike për dokumentet e planifikimit hapësinor si dhe cakton mënyrën e nxitjes së publikut në procesin e planifikimit hapësinor. Ky UA rregullon edhe procedurat e pjesëmarrjes publike nga fillimi dhe përgjatë të gjitha fazave të procesit të planifikimit hapësinor si dhe përcakton përmbajtjen e raportit të shqyrtimit publik bazuar në procesverbalet nga takimet e mbajtura.

iii) Dispozita të tjera relevante
Ligji për Ndërtim – rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit. Në nenin 17 të këtij ligji shkruan se “planet rregullative urbane janë dokumente publike dhe çdo person duhet të ketë qasje në to përmes ueb-faqeve komunale apo përmes kërkesës së palës”.

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit – përcakton rregullat për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme. Neni 15 i këtij ligji thekson se Drejtoria për Urbanizëm përpilon në baza javore listën e kërkesave të pranuar për projekte, që duhet të jetë publike dhe t’u shpërndahet anëtarëve të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit. Dosja e plotë e kërkesave për projekte duhet të mirëmbahet dhe të vihet në dispozicion për publikun nga Drejtoria për Urbanizëm. Ndërsa neni 14, paragrafi 8 përcakton se Këshilli duhet të publikojë punën e tij me informatë publike dhe se për këtë i raporton Kuvendit të Komunës.

II. Urbanizmi i mbyllur dhe pjesëmarrja e ultë e qytetarëve në Prizren

Transparenca e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor përgjatë 15 viteve të fundit ka qenë në nivel të ultë, gjë që ka pasqyruar të drejtpërdrejtë edhe në pjesëmarrjen e ultë të qytetarëve në konsultimet publike të organizuara nga ky dikaster. Gjatë monitorimit disa vjeçar të Urbanizmit të Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka qenë dëshmitare se mungesa e transparencës dhe e vullnetit për zbatimin e dispozitave ligjore për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor ka rezultuar me faktin që organet komunale në disa raste kanë marrë vendime që nuk përputhen me interesat e qytetarëve apo të banorëve të lagjeve të caktuara, që në rastet ekstreme ose nuk kanë pas bazë ligjore, ose kanë qenë në kundërshtim me ligjet në fuqi apo edhe me vet Kushtetutën e Kosovës.

Hulumtimet e tri viteve të fundit kanë treguar se afër 50% të qytetarëve nuk kanë njohuri apo informatë nëse qyteti i Prizrenit ka plan urban.⁷ Ndërsa anketimi i vitit të kaluar ka shpalosur faktin se vetëm 26% të anketuarve kanë njohuri se Prizreni ka plan zhvillimor, derisa 61% të tyre kanë theksuar se nuk e kanë këtë informatë. Rezultate të ngjashme kanë dalë edhe për sa i përket njohurisë së publikut për planet e ndryshme për zhvillimin e lagjeve, ku anketimi ka treguar se 30% të respondentëve e kanë këtë informatë, 22% janë përgjigjur negativisht dhe 43% kanë bërë të ditur se nuk dinë për këtë. Kur bëhet fjalë

⁷ “Planifikim urban për qytetarët 5”, Analizë, EC Ma Ndryshe, nëntor 2016, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/170209170458_08_12_2016_RBASHA_Analiza_5_Planifikimi_Urban_per_Qytetare_Final.pdf, qasur me 2 shtator 2017

se a kanë janë ftuar qytetarët personalisht apo përmes ftesave publike për të marrë pjesë në zhvillimin e ndonjë plani urban të qytetit, vetëm 10% të anketuarve janë përgjigjur me po, ndërsa 90% me jo. Sa i përket bashkëpunimit të qytetarëve në iniciimin e nismave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në lagjet e tyre, të anketuarit kanë deklaruar se 15% kanë qenë pjesë e iniciativave për të bërë ndryshime në lagjet e tyre, ndërsa 85% nuk e kanë bërë këtë gjatë viteve të fundit. Ndërsa pesë çështjet urbanistike të cilat janë adresuar më së shumti nga qytetarët janë: bllokimi i trotuareve, problemet e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuara, shkatërrimi i qendrës historike, mungesa e korsive për biçikleta dhe mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet.⁸

Transparenca e planifikimit urban dhe monitorimit të projekteve urbanistike të Komunës së Prizrenit ka qenë në nivele të ulëta gjatë dy viteve të kaluara edhe në bazë të vlerësimit të bërë në kuadër të Indeksit të Reformës së Transparencës Komunale.⁹

Të dhënat e mësipërme tregojnë se transparenca e organeve komunale sa i përket njoftimit të publikut për dokumentet e planifikimit hapësinor që janë në përgjegjësi të nivelit lokal, si për hartimin dhe zbatimin e tyre, është e ultë derisa një numër tejet i vogël i tyre janë ftuar për të qenë pjesë e procesit të konsultimeve për hartimin e tyre. Një gjë e tillë ka ndikuar negativisht edhe në zhvillimin e aktivizmit qytetar. Në anën tjetër preokupimet urbanistike të qytetarëve të Prizrenit mbeten në nivele bazike, që kryesisht ndërlidhen me lirinë e lëvizjes, dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe mjedisin, të cilat do të duhej të adresoheshin deri më tani nga niveli lokal. EC në kuadër të analizës për "Sfidat e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor në

⁸ Po aty

⁹ "Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale", Raport, EC Ma Ndryshe, prill 2016, linku: <http://online-transparency.org/indeksi/>

komuna" ka argumentuar se si planifikimi hapësinor duhet të pranohet si një disiplinë që siguron zhvillim të qëndrueshëm dhe që kërkon raporte efektive punuese mes politikanëve dhe sferave profesionale, derisa pjesëmarrja e publikut në hartim të dokumenteve të planifikimit siguron që plani të jetë i qëlluar. Duke marrë pjesë në hartim të dokumenteve të planifikimit, publiku mishërohet me planin, e fiton ndjenjën e pronësisë mbi planin si dhe angazhohet më shumë në zbatimin e tij. Komunitat e intervistuar për nevojat e kësaj analize patën vlerësuar se pjesëmarrja e publikut në hartimin e dokumenteve të planifikimit është e pamjaftueshme, ku mungesa e interesimit të publikut për të marrë pjesë në takimet e organizuara nga komuna dhe mosinformimi adekuat dhe mungesa e qasjes proaktive nga ana e komunës janë sfidat kryesore në këtë drejtim.¹⁰

Komuna e Prizrenit në dokumentet e veta strategjike ka pranuar se ka vështirësi në arritjen e vendosjes së një komunikimi të rregullt dhe të qëndrueshëm me qytetarët dhe grupe të interesit gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të akteve komunale me theks të veçantë të rregulloreve dhe të dokumenteve tjera strategjike sikurse janë planet rregullative apo të ngjashme. Madje organet komunale kanë theksuar se këto sfida në disa raste Komunës së Prizrenit i kanë sjellë vështirësi në komunikim me qytetarët dhe më tej edhe në zbatimin e vendimeve të marra nga organet e komunës.¹¹

¹⁰ "Sfidat e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor në komuna", Analizë, EC Ma Ndryshe, maj 2016, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335_EC_PRO_Analiza_SHQ.pdf, qasur me 5 shtator 2017.

¹¹ "Strategjia komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2015-2018", Komuna e Prizrenit, prill 2015, linku: [https://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Kuvendi-\(1\)/Regulations/strat_prill_2015_shqi.pdf.aspx](https://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Kuvendi-(1)/Regulations/strat_prill_2015_shqi.pdf.aspx), qasur me 3 shtator 2017

Drejtori i Urbanizmit në Komunën e Prizrenit ka shprehur qëndrimin se publiku është mesatarisht i informuar rreth dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit hapësinor, derisa nuk përdor mjete të avancuara për t'ia mundësuar publikut vëzhgimin e të gjitha elementeve që ndërlidhen me planet urbanistike. Sipas tij Komuna vetëm nga marsi i vitit 2017 ka nisur që ti publikojë në ueb faqen e saj zyrtare lejet e ndërtimit, ndërkohë që ato të shfrytëzimit të hapësirave publike nuk publikohen. Ky zyrtar i lartë ka pranuar se Ekzekutivi nuk ka raportuar mbi aktivitetet e veta për monitorimin e zbatimit të planeve përkatëse të DUPH-së, ani pse me legjislacion parashihet raportimi në KK për këto çështje. DUPH po ashtu nuk ka ofruar informata për publikun mbi performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për zhvillimin e planeve urbanistike.¹²

Përfaqësuesit nga komuniteti i profesionistëve kanë vlerësuar se dokumentet strategjike në fushën e planifikimit hapësinor nuk janë publike online, por se mund të qasen përmes kërkesave për qasje në dokumentet publike. Sipas profesionistëve Komuna e Prizrenit nuk përdor mjete të avancuara për t'ia mundësuar publikut vëzhgimin e të gjitha elementeve që ndërlidhen me planet urbane. Arkitektët kanë theksuar se nuk ka raportim e as monitorim të mirëfilltë të zbatimit të planeve përkatëse të DUPH-së, gjë që sipas tyre paraqet problemin më të madh në terren. Njëkohësisht konsiderojnë se DUPH përkatësisht Komuna nuk ka ofruar informata për publikun mbi performancën e kompanive të kontraktuara nga komuna për zhvillimin e planeve urbanistike.¹³

Sipas komunitetit të profesionistëve por edhe monitoruesve të shoqërisë civile praktika e

¹² Intervistë me Visar Islamaj, drejtor i DUPH në Komunën e Prizrenit, me 8 shtator 2017.

¹³ Intervistë me Arnet Haskuka, arkitekte dhe anëtare e Këshillit të Trashëgimisë Kulturore në Prizren, me 7 shtator 2017.

mbylljes së Komunës së Prizrenit së fundmi ilustron më së miri me nismat për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit dhe Planit të Mobilitetit për qytetin e Prizrenit. Ndonëse këto dy dokumente strategjike janë mjaft të rëndësishme deri më tani nuk është publikuar pothuajse asnjë informatë mbi rrjedhën e hartimit të tyre, me ç'rast as anëtarët e Këshillit të Trashëgimisë Kulturore në Prizren nuk janë përfshirë në proces. Ndërkohë as anëtarët e shoqërisë civile që janë aktivë në këto fusha nuk janë ftuar ende për konsultime dhe kontribut në këtë drejtim.

Krahas DUPH-së që si autoritet komunal mbulon tërë territorin e Komunës së Prizrenit, për çështjet urbanistike që kanë të bëjnë me Qendrën Historike të Prizrenit duhet të konsultohen edhe Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore dhe Këshilli për Trashëgimi Kulturore në Prizren.

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit mes tjerash parasheh që Drejtoria për Urbanizëm të përpilojë në baza javore listën e kërkesave të pranuar për projekte, që duhet të jetë publike dhe t'u shpërndahet anëtarëve të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit. Dosja e plotë e kërkesave për projekte duhet të mirëmbahet dhe të vihet në dispozicion për publikun nga Drejtoria për Urbanizëm. Kjo kërkesë ligjore ende nuk zbatohet në formën e duhur.

Ndërkohë drejtuesit e QRTK dhe të KTK pranojnë se pëlqimet dhe rekomandimet e tyre nuk janë publikuar online deri më tani.

Përgjegjësit në QRTK kanë pohuar se ky organ i trashëgimisë kulturore nuk ka ueb faqe të veten dhe se çështja e uebit është e centralizuar pasi që kjo Qendër është nën varësinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Sipas tyre vullneti i QRTK-së ekziston për publikimin e pëlqimeve dhe dokumenteve tjera zyrtare por aktualisht mungon ueb faqja dhe kapacitetet njerëzore. Megjithatë kanë pohuar se QRTK është e hapur për të lejuar qasjen në të gjitha dokumentet e kësaj qendre. Njëkohësisht

drejtori i kësaj qendre ka theksuar se informatat për projektet dhe aktivitetet e ndryshme të QRTK-së në Prizren i publikon në profilin personal të rrjetit social, Facebook.¹⁴

Ndërsa përfaqësuesit e KTK-së kanë bërë të ditur se rekomandimet e këtij Këshilli nuk publikohen për shkak të mungesës së logjistikës, meqë ky trup këshilldhënës nuk ka ueb faqe, por as kompjuterë e lidhje interneti. Ndërsa hapja e një faqeje në rrjetin social, Facebook, kanë thënë se është një iniciativë e Këshillit për informimin e publikut për punën e këtij trupi.¹⁵ Sipas legjislacionit në fuqi ky Këshill duhet të publikojë punën e tij me informatë publike dhe për këtë të raportojë në Kuvendin e Komunës. KTK periodikisht ka raportuar në KK, por ka munguar publikimi për punën e bërë përmes informatave publike. Duke qenë se KTK është organ i themeluar nga KK-ja e Prizrenit, atëherë pushteti lokal i Prizrenit duhet të krijojë kushte më të mira që KTK-ja të rris transparencën, qoftë edhe përmes publikimeve të rregullta në ueb faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.

Të gjitha argumentet e cekura tregojnë se rrethi institucional që ka të bëjë me urbanizmin dhe planifikimin hapësinor në Prizren është jotransparent përballë publikut, ndërkohë që përpjekjet për përfshirjen e publikut në konsultime dhe vendimmarrje janë në nivele minimale, aq sa mjafton për të përmbushur kriteret e kërkuara me ligj. Kësisoj procesi i përgatitjes së dokumenteve të planifikimit urban e hapësinor në Prizren mbetet i mbyllur për publikun njëjtë sikurse që për zbatimin e tyre në praktikë nuk ka mjete që do t'ia mundësonin publikut vëzhgimin e të gjitha elementeve që ndërlidhen me planet urbanistike. Si rrjedhojë edhe qyteti i Prizrenit bashkë me bërthamën e saj qendrore janë

¹⁴ Intervistë me Samir Hoxha, drejtor i QRTK në Prizren, me 8 shtator 2017

¹⁵ Intervistë me Arbnor Morina, kryesues i KTK në Prizren, me 8 shtator 2017

përballë me degradim dhe ndërtime jashtë kriterëve urbanistike.

Monitorimi i EC-it në vitet e kaluara ka nxjerrë në pah faktin se mos respektimi i kriterëve të ndërtimit nuk ndëshkohet nga institucionet (përfshirë ato të drejtësisë), gjë që ka ndikuar që ndërtimet të realizohen me shpërfillje të lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja. Madje dëshmi për degradimin urbanistik të Prizrenit pat dhënë vite më parë edhe një shkresë zyrtare e Drejtorisë së Urbanizmit drejtuar Drejtorisë së Inspektoratit, në të cilën, në mes tjerash thuhej se “në bazë të evidencës që posedon shërbimi i DUPH ju njoftojmë se ndërtimet të cilat janë duke u zhvilluar kohëve të fundit janë mjaft shqetësuese; ato të cilat kanë leje ndërtimi mbi 80% nuk i janë përmbajtur lejes së ndërtimit ndërsa një numër shumë i madh i ndërtimeve tjera janë pa kurrfarë leje të ndërtimit. Shërbimi i DUPH-së është i shqetësuar sidomos në lokacionet për të cilat disponon me plane rregulluese (Prevallë, Jeni Mëhallë, Lakuriqi, Dardania etj) ndërsa në brendinë e tyre ndërtohet duke mos ju përmbajtur planeve rregulluese”.¹⁶ Ndërkohë sipas QRTK në 90 për qind të lejeve ndërtimore për objektet në Qendrën Historike të Prizrenit ka tejkalime të natyrave të ndryshme, si në gabarit, në etazhitet, në detaje apo në fasada.¹⁷

III. Rekomandime

¹⁶ “Degradimi natyror dhe urbanistik”, Raport nga EC Ma Ndryshe, 2013, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/EC_Degradimi_natyror_dhe_urbanistik_final_analiza.pdf, qasur me 1 shtator 2017.

¹⁷ Samir Hoxha, drejtor i QRTK, deklarim në mbledhjen e Task Forcës për Qendrën Historike të Prizrenit, 30 maj 2016

Komuna e Prizrenit përkatësisht DUPH-ja duhet të hap dokumentet e planifikimit hapësinor për publikun, si për të përmbushur obligimet e Kartës për Hapjen e të Dhënave ashtu edhe për të rritur nivelin e llogaridhënies publike;

Bashkë me hapjen e të dhënave dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor Komuna përkatësisht DUPH-ja duhet të krijojë mundësi më të mëdha për mbikëqyrjen e punës së autoriteteve publike në raport me urbanizmin, lejet e ndërtimit, planifikimin zhvillimor dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore;

Komuna të krijojë një platformë digjitale për pjesëmarrje publike, përmes të cilës qytetarët do të shpalosin para autoriteteve të komunës, shqetësimet dhe problemet që i kanë me çështjet e ndryshme urbanistike, shërbimet publike, etj.;

Komuna duhet të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile rreth organizimit dhe lehtësimit të diskutimeve publike rreth planeve urbane, ku rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet targetimit të grupeve të marginalizuara të komunitetit për t'u siguruar në pjesëmarrje sa më të gjerë dhe të barabartë në procesin e hartimit të planeve urbane;

Diskusimet publike të zhvillohen në grupe të vogla (15-20 vetë) brenda grupeve të caktuara të komunitetit (gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, të moshuarit, lagjet informale, ambientalistët, artistët, etj.);

Ftesat për diskutime publike pos mënyrave që tashmë përcaktohen me ligj, duhet të bëhen edhe përmes SMS-ve dhe e-mailave; përmes organizatave të komunitetit tek anëtarësitë e tyre, si dhe platformave të medieve sociale. Bashkë me ftesën për diskutimin publik, të shpërndahet një përmbledhje tekstuale dhe grafike (1 fq. A4) mbi planin urban në diskutim. Në ueb faqen e komunës, para diskutimit të publikohet përmbledhja grafike dhe tekstuale e

lagjes dhe propozimit për të (varësisht prej fazës së planifikimit që do të diskutohet);

Gjatë diskutimeve publike, përveç në mënyrë grafike e tekstuale, të prezantohen edhe me anë të maketave të një shkallë të lexueshme, lagjja, vizioni dhe intervenimi i propozuar (varësisht prej fazës së planifikimit që vihet në diskutim);

Diskusimet publike të realizohen në dy forma: Diskutimi plenar (një në fillim të fazës planifikuese dhe një në përmbyllje) dhe diskutimi në formën e tryezës së rrumbullakët (të ndarë në grupe të komunitetit);

Përveç takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët, drafti i planit urban (pjesa grafike dhe tekstuale) të vendosen në ueb faqen e komunës, për t'u ofruar mundësi komentimi qytetarëve që nuk kanë mundësi të jenë prezent fizikisht në diskutimet publike.